



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Lubjana nga OTP Bank Nyrt.

Përfaqësuesi ligjor i palës njoftuese me shkresën Nr.353 Prot i AK, datë 03.06.2019 “Shkresë përcjellëse në lidhje me njoftimin për përqendrim të OTP Bank Nyrt”, ka njoftuar në lidhje me transaksionin e kryer jashtë Shqipërisë nga shoqëria OTP Bank Nyrt për përfitimin e kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi: **OTP Bank Nyrt** është shoqëri aksionare hungareze. Aktivitetet e OTP janë ndërmjetësim monetar si dhe qira financiare, aktivitete të tjera të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensione; brokerimi i kontratave të letrave me vlerë; aktiviteti i agjentëve dhe brokerave të sigurimit; aktiviteti i menaxhimit të fondeve; aktiviteti i kontabilitetit; llogari-mbajtjes dhe auditimit, konsulencës fiskale; qiradhënia dhe operimi i pasurive të paluajshme në pronësi ose me qera.

Shqipëri: Aktualisht OTP është prezente nëpërmjet filialit të saj OTP Bank Albania SH.A.

Shitësi: **Societe Generale** është shoqëri anonime franceze. Societe Generale është një nga organizatat më të mëdha për ofrimin e shërbimeve financiare në Evropë. Aktivitetet e saj përfshijnë shërbime bankare për konsumatorët, kredi për shtëpi, kredi personale, depozita personale; shërbime bankare për korporatat dhe investime, kredi, depozita, llogari bankare për entitete juridike; shërbime financiare; shërbime bankare private; menaxhimi i aseteve; shërbime me letrat me vlerë etj.

Shqipëri: Societé Générale nuk është më prezente dhe nuk ushtron asnjë aktivitet tregtar në Shqipëri.

Shoqëria target: SKB Banka d.d. Ljubljana, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, aktiviteti i së cilës përfshin: shërbimet me konsumatorin; korporatat dhe investimet bankare; shërbimet financiare; shërbimet e pagesave; shërbime leasing etj

Shqipëri: Shoqëria SKB Banka nuk është prezente në Shqipëri.

OTP Bank Nyrt synon të blejë 97.58% të kapitalit me të drejtë vote të SKB Banka dhe më pas 2.14% të aksioneve të zotëruara nga Généfinance SASU (filial i zotëruar tërësisht nga

Société Générale). Përqendrimi i propozuar ka të bëjë me përfitimin e drejtpërdrejtë të kontrollit influencues të SKB Banka d.d. Lubjana.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga publikimi, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.